Kronikë

Vrasje e dyfishtë në Dukagjin, qëllohet për vdekje kryeplaku i fshatit Bruçaj dhe djali i tij! Mbrëmë u dogjën shtëpinë, sot autorët i zunë në pritë

*Ekzekutohen në Dukagjin babë e bir, **Gjokë dhe Eduard Gurra**. Viktimat shkuan për të parë shtëpinë e djegur një natë më parë, kur u qëlluan për vdekje. Dyshohet se djegia e shtëpisë ishte kurth për ti nxjerrë në pritë. **Gjokë Gurra ka qenë polic në Shkodër deri në 2008** dhe më pas ka punuar me transport lëndësh drusore. Ai ishte kryeplaku i fshatit Bruçaj.*

- FOTO/ Këta janë babë e bir që u vranë sot në Shkodër
- U ekzekutua bashkë me të birin në Dukagjin, Gjokë Gurra më parë ishte pjesë e policisë së Shkodrës
- Vrasja e dyfishtë në Dukagjin, reagon policia: Ende nuk dihen motivet
- Vrasja e dyfishtë në Dukagjin, dalin emrat, kush janë babë e bir

Redaksia
29 Qershor, 17:49 | **Përditesimi: 29 Qershor, 21:52**

SHKODËR- Një vrasje e dyfishtë ka ndodhur ditën e sotme (29 qershor 2023) në Dukagjin të Shkodrës. Babë e bir, Gjokë Gurra dhe Eduard Gurra janë ekzekutuar për vdekje nga persona ende të paidentifikuar. Report Tv mëson se babë e bir janë zënë në pritë në shtëpinë e tyre në Dukagjin, ndërsa prej vitesh jetonin në qytetin e Shkodrës. Gjokë Gurra ishte kryeplak i fshatit Bruçaj.

Policia thotë se ngjarja ka është regjistruar rreth orës 16:40, në fshatin Sumë, Njësia Administrative Pult. Një zjarrëvënie e qëllimshme e shtëpisë së tyre në Dukagjin një natë më parë, ka bërë që Gjokë Gurra, 57 vjeç dhe Eduard Gurra, 31 vjeç, të shkojnë në vendin e origjinës së tyre për të parë dëmet e shkaktuara. Persona ende të paidentifikuar i kanë vënë flakën shtëpisë, ndërsa duket si një skenar i përgatitur për t'i zënë në pritë babë e bir.

LEXO EDHE:
Shkodër/ I vunë tritol në garazh 52 vjeçarit, në kërkim 2 ish-futbollistë, shkak sherri për shezlongët, dy javë më parë i dhunuan të afërmin (EMRAT)

Të dy viktimat rezultojnë pa precedentë penalë, madje Gjokë Gurra kishte punuar në Policinë e Shkodrës, deri në vitin 2008, kur ka dhënë dorëheqjen. Prej rreth 15 vitesh, bashkë me djalin ka punuar kryesisht me lëndë drusore për ngrohje dhe transportimin e tyre në Shkodër. Ende nuk dihen motivet e kësaj ngjarje të rëndë, ndërsa një ndër pistat e hetimit dyshohet mund të ketë lidhje me kultivimin e kanabisit.

Gjokë Gurra ishte babai i dy djemve, ndërsa djali i tij Eduarti ishte baba i dy vajzave. Ende po punohet për identifikimin e autorit/autorëve që mund të fshihen pas kësaj ngjarjeje.

Gjokë dhe Eduard Gurra

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Ora 19:34

U vra bashkë me djalin në Dukagjin, Gjokë Gurra është kryeplak i fshatit Bruçaj

Report Tv mëson se Gjokë Gurra, i cili u ekzekutuar ditën e sotme në Dukagjin bashkë më djalin, është kryeplak i fshatit Bruçaj. Ende nuk dihen arsyet e vrasjes, ndërsa ata u zunë pritë në shtëpinë e tyre në Dukagjin, teksa apo shihnin dëmet e shtëpisë nga një zjarrëvënie e qëllimshme një natë më parë.

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 19:19

U ekzekutua bashkë me të birin në Dukagjin, Gjokë Gurra më parë ishte pjesë e policisë së Shkodrës

Gjokë Gurra, i cili u ekzekutua ditën e sotme në Dukagjin të Shkodrës, bashkë me të birin, ka qenë pjesë e Policisë së Shkodrës. Mësohet se Gurra ka punuar si efektiv deri në vitin 2008, ndërsa më pas është larguar nga detyra me dëshirën e tij.

Ai ka punuar kryesisht me lëndë drusore për ngrohje dhe transportimin e tyre në Shkodër së bashku me të birin prej gati 15 vitesh.

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 18:04

FOTO/ Vrasje e dyfishtë në Dukagjin, Report Tv siguron foton e viktimave! Babë e bir u ekzekutuan teksa ishin duke parë dëmet e shtëpisë së tyre

1 / 8



Gjokë Gurra dhe Eduard Gurra

Gjokë Gurra dhe Eduart Gurra, babë e bir janë ekzekutuar pasditen e kësaj të enjteje në Dukagjin. Report Tv ka siguruar foton e babë e bir të ekzekutuar në Dukagjin.

G.MO/Shqiptarja.com

Ora 18:04

Vrasja e dyfishtë në Dukagjin, reagon policia: Babë e bir u qëlluan me armë zjarri, nuk dihen arsyet

Policia ka reaguar për vrasjen e dyfishtë në Dukagjin të Shkodrës. Policia thotë se babë e bir, Gjokë Gurra dhe Eduart Gurra janë qëlluar me armë zjarri për motive që ende nuk dihen.

> *Shkodër/Informacion paraprak*
>
> *Rreth orës 16:40, në fshatin Sumë, Njësia Administrative Pult, në rrethana ende të paqarta janë vrarë me armë zjarri shtetasit Gj. G., 57 vjeç dhe djali i tij, E. G., 31 vjeç, banues në lagjen "Partizani", Shkodër.*
>
> *Shërbimet e Policisë dhe Grupi hetimor janë nisur menjëherë për në vendngjarje.*
>
> *Me mbërritjen e shërbimeve dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes do të japim përsëri njoftim më të detajuar.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 17:55

Vrasja e dyfishtë në Dukagjin, dalin emrat, kush janë babë e bir që u ekzekutuan

Një vrasje e dyfishtë ka ndodhur sot në Dukagjin të Shkodrës. Report Tv mëson se janë ekzekutuar Gjokë Gurra dhe Eduart Gurra.

SI.E./Shqiptarja.com

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: vrasje | eduard gurra | Shkoder | Gjoke Gurra | dukagjin

Komento

Komente

ENVER HOXHA: 30/06/2023 10:39

TE ISHA DHE NJEHER GJALL!!!

Përgjigju

Dhurata Uruci shkoder: 30/06/2023 09:32

Te hetohet Dhurata Uruci per Korrupsion dhe shperdorim detyre ne spitalin shkoder , spak dhe Bkh te fillojne hetimet. Te shikohet sasia e lekeve cash qe ka ne shtepi , 900 miljon lek cash , mjekja me dy fytyra klloun palaqo

Përgjigju

dhurata: 30/06/2023 09:38

????

Agron: 30/06/2023 07:59

Do kete vite qe ja ka marre shpirtin fshatit,nje her si polic,me pas kryeplak i perjetshem (edhe pse jeton ne shkoder qytet?),me tej edhe me shfarosjen e drureve te pyllit,me tej me hashash dhe transport hashashi sigurisht me makinat e drureve dukagjin-shkoder,dhebpasi eshte ngop me leke do i ket hyp vetja ne qejf dhe ja ka bere borxh vrasesve .

Përgjigju

Agron: 30/06/2023 10:11

I ka hyp vetja ne qejf dmth ngacmim te grave dhe vajzave te fshatit,mos llogaritja per burr asnje ne fshat duke i spiunuar,gjobitur,ofenduar etj.

Populli: 30/06/2023 09:03

Nuk besij qe vetem pse te hyp vetja ne qejf duhet te vritesh por kushedi se ku jane problemet.

ymeri: 30/06/2023 04:18

as greku e as serbi nuuk na ka vrare sa jemi vrare ne mes vetes tone.....turp...rrace hahvani....

Përgjigju

tani: 30/06/2023 01:49

mos vrisni komshinjte dhe njerezit e juaj ,, o hale,,,shteti ti vraase keta vrases...

Përgjigju

Ceni: 30/06/2023 01:13

Keta te “beses”!!

Përgjigju

Alb: 30/06/2023 00:05

Shqiptare po jeton si ne kohe te zogute, skamje papunci krim edhe injoranca ne kry te shtetite.

Përgjigju

Berti: 29/06/2023 20:15

Kur ndodh e keqja behemi te gjithe te zgjuar,por 2 viktimat duhet ta kishin vleresue djegjan e shtepise dhe te b/punonin me policine.Ata qe jane vrare e dine se kush.Eshte nje shkak,qe ka sjell kete pasoje.Nuk eshte veshtire te gjendet,por iken 2 veta.Gjithesesi ngushllime familjes se tyre.

Përgjigju

Vasili: 29/06/2023 19:49

A ka shkue policia per rastin e djegjes se shtepise.Apo duhej bere vrasja qe te shkohet.Megjitheate ky eshte nje rast qe do zbulohet shpejt.

Përgjigju

Safeti: 29/06/2023 19:44

Droga. Krimi. Droga. Shaljanet me Bajrat nuk shkojne mire. Kaq di te them

Përgjigju

petrit: 30/06/2023 09:19

Ku ka hy droga , vetem krime ka dhe do te kete ne vazhdimesi,Ky material i lig hyn brenda cdo familje dhe shoqerie dhe e shkaterron. Bota eshte e njohur me kete fenomen dhe ja din pasojat, tani se fundmi po ja shohim "hajrin" edhe ne.

Shqiperi Hesapi: 29/06/2023 19:33

Do ket ndonje lidhje me ata qe kapi policia para disa ditesh,babai kryeplak kush e di ku ka pare gje dhe ka folur... E frikshme jeta ne shqiperi.

Përgjigju

Arben: 29/06/2023 19:24

Edhe ne vitin 2023 do vuajme pasojat e bemave te Saliut ne 1997? Me hapjen e depove te armeve me urdher te Saliut atehere, ende sot vriten shqiptaret! Kur do mbaroje kjo e keqe?

Përgjigju

Riku: 30/06/2023 07:07

Hot dog sigurisht vetem pjesen pa brume... a po fajin e ka saliu

Or tej: 29/06/2023 23:51

Nqs jane larje hesapesh per drogen, armet, po te jete nevoja, futen edhe pa Saliun/Meten/Ramen or tej

Dhendri i Besnik Bekteshit: 29/06/2023 19:23

Promovojme turizmin malor.

Përgjigju

Polo: 29/06/2023 23:23

Me pak gjelbërim.....

Halit: 29/06/2023 19:01

Paçin dheun e lehte. I gjen rrumbullaku direkt pa merak

Përgjigju

Shkodra: 29/06/2023 18:34

Mos ka lidhje me keto arrestimet qe u ben 2 dit me par ?? Ndonje spiunllek a nej gja ??? Se dhe ky djali me range rover gjith diten xhiro diku i ka marr ato lek

Përgjigju

Gjynah: 29/06/2023 19:40

Me sa e njoh une Edin, i rralli djal ne Shkoder ka ken ma djal puntor se ai. Paçin drite!

Beni: 29/06/2023 18:28

Ne shkoder nuk kishin nai emer te mire e kerkoshin me zor konfliktin.. gjynah me kte fund!

Përgjigju

Xeni: 29/06/2023 17:54

Albanistani vend i papare per te jetuar

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:

Partitë e vogla propozojnë të votojnë edhe 16-vjeçarët, jeni dakord?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Zjarri në apartamentin e pallatit në Shkodër, Benet Beci viziton familjarët! Inspekton dëmet e shkaktuara nga flakët

30 Qershor, 09:24



Kryefamiljari harroi cigaren ndezur, përfshihet nga flakët kati i 4-t i pallatit në Shkodër! Asfiksohet një qytetar, dërgohet në spital (VIDEO)

30 Qershor, 08:37

Shkodër, shpërthim në garazhin e një banese në lagjen '10 Korriku'

29 Qershor, 10:05

Po të flisnin muret do rrëzoheshin universitetet!

Denis Dyrnjaja

28 Qershor, 13:06

Goditi me sende të forta të riun pas një sherri për motive të dobëta, në kërkim 38-vjeçari në Shkodër

27 Qershor, 15:05

Shkodër, Benet Beci emëron krahun e djathtë! I beson pedagogut Rudin Beka postin e nënkyetarit

27 Qershor, 13:18

Rektorja e universitetit të Shkodrës në kërkim për korrupsion, kreu i sindikatës së pedagogëve: E turpshme që nuk ka reagim nga senati akademik

27 Qershor, 10:08

Restaurohet shtatorja e Shën Mëhillit, vepër e Idromenos

Ergys Kavaja

26 Qershor, 20:27

Hetimi për zv.drejtorin dhe 12 policët e komisariatit Shkodër, Prokuroria: Dekonspiruan operacionet, ishin 'informatorë" të kultivuesve të kanabisit

26 Qershor, 17:07

Në kërkim ndërkombëtar për grup kriminal, arrestohet 23-vjeçari në Pukë

26 Qershor, 15:32

Aksioni i policë/ Pastrohen trotuaret e Shkodrës nga tendat e lokaleve

26 Qershor, 12:57

Kosovë/ Dy vëllezër vriten në Gjakovë

25 Qershor, 21:28

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje